

NJOFTIM PUNE

Balfin Group është një ndër grupet private investuese më të mëdha në Shqipëri dhe rajon, i pranishëm me aktivitete për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, shitjet me pakicë, ofrimin e shërbimeve dhe manaxhimin e hapësirave tregtare apo industrial, miniera e metalurgji, etj.

Agrocon Albania Sh.p.k është një kompani shqiptare që zhvillon aktivitetin e saj në fushën e bujqësisë. Aktivitetet përfshin prodhimin e perimeve të fresketa në serë, në fushë të hapur, grumbullimi i perimeve nga fermerët e zonës si dhe shitja me shumicë për eksport dhe në tregun shqiptar.

Pozicioni: Manaxher Grumbullimi Fruta/Perime

Raporton: Administratori i Kompanisë

Shoqëria: Agrocon Albania shpk

Vendndodhja: Fshati Ngurrëz e Vogël, Lushnje

Përmbledhje: Manaxher i Grumbullimit ka si funksion kryesore gjetjen dhe blerjen e prodhimeve të fresketa nga palë të treta në zonë dhe më gjerë.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Identifikon në bashkëpunim me As. e Grumbullit fermerë nga të cilët kompania do të blej produkte që ata prodhojnë;
- Merret me studimin e tregut dhe luhatjeve të çmimeve të blerjes së perimeve tek palet e treta;
- Planifikon procesin e grumbullimit bazuar në nevojat e identifikuar paraprakisht nga drejtuesi i Departamentit të Shitjes;
- Njek finalizimin e procesit të grumbullimit dhe kontrollit të cilësisë, si dhe për të garantuar që informacioni i përfituar nga aktiviteti i këtij procesi të jetë në përputhje me procedurat e miratuara të Shoqërisë;
- Ka përgjegjësinë e zbatimit të procedurave të shoqërisë për procesin e grumbullimit e të mbulimit të kompetencave, dhe të garantoj zbatimin cilësisë për eksport;
- Bashkëpunon me Departamentin e Shitjeve për standartin e cilësisë së furnitorëve dhe ndaj klientëve;
- Ndjeke cilesinë e prodhimit dhe arritje e pritshmerive nepermjet As. Te grumbullimit;
- Punon së bashku me punonjësit e magazinës dhe Përgjegjës të Magazinës për të siguruar që procesi i Grumbullimit dhe i Kontrollit të Cilësisë funksionon siç duhet;
- Mbikëqyr të gjitha mënyrat dhe procedurat e për grumbullimin e produktit dhe gjen zgjidhjen e problemeve në lidhje me klientët, si edhe informon Administratorin për veprimet korrigjuese të kërkuara;

Raporton tek Administratori i Përgjithshëm dhe mbi ecurinë e procesit të Grumbullimit e të Kontrollit të Cilësisë dhe çdo nevojë tjetër për përmirësim;

Kërkesa dhe kualifikime

Edukimi: Diplomë Universitare në Ekonomi, Agrobiznes.

Eksperiencë Pune: Minimalisht eksperiencë 5 vjeçare të mëparshme në fushën grumbullimin apo tregtinë e fruta/perimeve përbën përparësi.

Kualifikime të tjera:

- Aftësi të shkëlqyera organizative, duke përfshirë aftësi për të planifikuar punën dhe vendosur prioritete;
- Aftësi të shkëlqyera komunikuese, të zotërojë etikë pune dhe integritet;
- Afësi të shkëlqyera analitike dhe aftësi për të zgjidhur në mënyrë efikase problemet;
- Të zotërojë gjuhën angleze;
- Aftësi shumë të mira për të ruajtur informacionin konfidencial;
- Të ketë aftësi në përdorimin e kompjuterit të raporteve numerike;
- Aftësi për të koordinuar punën;
- Aftësi për të punuar në grup dhe për të marë iniciativë
- Të ketë automjet personal;
- Të jetë në gjendje për të udhëtuar brenda dhe jashtë Shqipërisë;
- Të ketë patentë për drejtimin e automjetit.

Procedura e aplikimit:

Për të aplikuar për këtë pozicion, jeni të lutur të dërgoni CV tuaj nëpërmjet emailit tek adresa hr@agroconalbania.al

Afati i dorëzimit: 31 Tetor 2017

Do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur për intervistë.

* Të gjithë aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet sipas ligjit Nr.9887 të vendosur nga Parlamenti i Shqipërisë mbi "Mbrojtjen e të dhënave personale".